

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS** – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Hashim Çollaku kryetar i kolegjit, Ferit Osmani dhe Shqipe Qerimi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Shaban Prekalla, në çështjen penale kundër të akuzuarit H.H., nga fshati ,,,, Komuna e Vitisë, për shkak të veprës penale Rrezikim i trafikut publik, nga neni 378 paragrafi.8 lidhur me par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK)-së, duke vendosur përkitazi me ankesën e Prokurorisë Themelore në Gjilan, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan-Dega në Viti, P.nr.317/2017, datë 05.10.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur më 11.01.2019, mori këtë:

## A K T G J Y K I M

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Gjilan, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan-Dega në Viti, P.nr.317/2017, datë 05.10.2018, **Vërtetohet**.

## A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Gjilan-Dega në Viti, me aktgjykimin P.nr.317/2017, datë 05.10.2018 të akuzuarin H.H. për shkak të veprës penale Rrezikim i trafikut publik, nga neni 378 paragrafi.8 lidhur me par.1 të KPRK-së, e ka shpallë fajtor dhe e ka gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 180 ditësh, dënimi me kusht nuk do të ekzekutohet me kusht që brenda 2 vitesh të mos kryej veprë tjetër penale. Është obliguar i akuzuari që të paguaj shpenzimet e procedurës penale në shumën prej 30 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pasi aktgjykimi të merr formë të prerë. Palët e dëmtuara, për realizimin e kërkesës pasurore juridike janë udhëzuar në kontest të rregull juridiko civil. Është refuzuar propozimi i prokurori i shtetit konform nenit 62 të KPRK-së, që të akuzuarit ti ndalohet vozitja e automjetit për kohë të caktuar.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ankesë ka paraqitur Prokurori i Prokurorisë Themelore në Gjilan dhe atë për shkak të vendimit mbi dënimin me propozim që Gjykata e Apelit në Prishtinë, të ndryshohet aktgjykimi i ankimuar sa i përket vendimin lidhur me sanksionin penal, në atë mënyrë që të akuzuarit, ti shqiptoj dënim me burgim efektiv.

Prokurori i Apelit, me parashtrësën me shkrim PPA/II.nr.4/2019, datë 08.01.2019, ka propozuar që të aprovohet si e bazuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Gjilan, ashtu që

aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe të akuzuarit ti shqiptohet një dënim më i lartë dhe me burgim efektiv.

Gjykata e Apelit pasi shqyrtoj të gjitha shkresat e kësaj çështje juridiko-penale, studioj aktgjykimin e ankimuar në kuptim të nenit 394 të KPPK-së, dhe pas vlerësimeve të pretendimeve në ankesë, gjeti se:

### **Ankesa nuk është e bazuar.**

Edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë nuk animohet për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, më gjithat Gjykata e Apelit të njëjtin sipas detyrës zyrtare e shqyrtoj edhe në këtë aspekt, konform dispozitës së nenit 394 të KPPK-së dhe konstatoj se ai nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, e të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e tij, si dhe as shkelje të Ligjit Penal në dëm të akuzuarit.

Po ashtu as gjendja faktike nuk ka qenë objekt vlerësimi e kësaj gjykate, ngase në ankesë nuk ka mundur të kontestohet, sepse i akuzuari në shqyrtimin gjyqësor e ka pranuar fajësinë për të gjitha pikat e akuzës, edhe gjykata është pajtuar me një pohim të tillë, prandaj sipas nenit 383 par. 2 të KPPK-së, ndaj aktgjykimin që është marrë në bazë të pranimit të fajësisë ose marrëveshjes për pranimin e fajësisë nuk lejohet ankesa për gjendjen e fakteve, aktgjykimi i ankimuar u vlerësua vetëm në frymën e pretendimeve ankimore sa i përket vendimit për dënim.

Sa i përket vendimit mbi dënimin në ankesë prokurori pretendon se Gjykata e shkallës së parë drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike lidhur me rastin konkret, por konsideron se gjykata e shkallës së parë të akuzuarit nuk i ka shqiptuar dënim të merituar sipas ligjit, kështu që këtë dënim e zbuti deri në atë masë që bie në kundërshtim me rregullat e përgjithshme për matjen e dënimin në kuptim të nenit 74,75, dhe 76 të KPRK-ës. Se rrethanat lehtësuese çfarëdo çofshin ato assesi në rastin konkret nuk kanë guxuar të vlerësohet që janë të asaj rëndësie që të ndikonin që dënimin të zbutet deri në këtë nivel sikur se në dispozitivin e aktgjykimin të ankimuar. Në rastin konkret të gjitha rrethanat lehtësuese të potencuar në arsyetimin e aktgjykimin të ankimuar nuk e kanë atë rëndësi që dënimin të zbutet nën minimumin e paraparë ligjor, se gjykata e shkallës së parë nuk i ka kushtuar rëndësi rrethanave tjera rënduese si pasojat që ju janë shkaktuar tre të dëmtuarve se aksidenti është shkaktuar me lëshime ekskluzive të akuzuarit dhe atë për shkak të shpejtësisë së lëvizjes me automjet, e që veprimet e tilla kanë qenë të rrezikshme për pjesëmarrësit në aksident, andaj, prokurori i shtetit pretendon se po nëse ishin marrë parasysh rrethanat tjera rënduese dhe të vlerësoheshin në mënyrën e duhur, sigurisht se sanksioni penal do të ishte më i ashpër për të akuzuarin, edhe se me një dënim më të ashpër do të arrihet qëllimi i dënimin.

Gjykata e Apelit, vlerëson se pretendimet ankimore të prokurorit për një dënim më të ashpër nuk janë të bazuara. Gjykata e shkallës së parë me rastin e caktimit të dënimin i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 73 dhe 74 dhe 75 të KPRK-së. Si rrethana lehtësuese për të akuzuarin gjeti se i akuzuari ka pranuar fajësinë, se i njëjti është penduar për kryerjen e veprës penale, se premtoj se në të ardhmen do të ketë kujdes ë

të shtuar gjatë vozitjes, se është i gjendjes së vështir ekonomike, është hera parë që ka rënë ndesh me ligjin, se është prind i 4 fëmijëve të mitur, mbajtës i vetëm i familjes, kujdestar i motrës së sëmurë 40 vjeçare, ndërsa si rrethanë rënduese për të akuzuarin gjykata e shkallës së parë ka marrë parasysh shkallën e përgjegjësisë së veprës penale, rrezikshmërinë shoqërore dhe natyrën e lëndimeve dhe dëmin e shkaktuar të dëmtuarve. Një vlerësim të këtillë të rrethanave relevante për matjen e dënimit si të drejtë dhe të ligjshëm e pranon edhe kjo gjykatë, e gjen se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë i ka konstatuar dhe vlerësuar të gjitha rrethanat të cilat ndikojë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, pretendimi i Prokurorit se dënimi i shqiptuar nuk ka mbështetje ligjore dhe se gjykata nuk ka marrë për bazë rrethanat rënduese në rastin konkret, sipas vlerësimit të kësaj gjykate nuk është i bazuar, ngase duke marrë parasysh peshën e veprës penale dhe rrethanat të cilat i ka konstatuar dhe vlerësuar gjykata e shkallës së parë del se dënimi i shqiptuar është i drejtë dhe i ligjshëm, e me qenë se në ankesën e Prokurorit nuk theksohet ndonjë rrethanë e re rënduese, e që nuk është vlerësuar nga gjykata e shkallës së parë dhe që do të ndikonte në shqiptimin e ndonjë dënimi më të ashpër, si dhe duke marrë parasysh si rrethanë veçanërisht lehtësuese pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe rrethanat e rastit konkret, kjo gjykatë vlerëson se dënimi i shqiptuar si në dispozitivin e aktgjykimit të ankimuar, ndaj të akuzuarit është në përpjesëtim me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale, me shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit si ekzekutor dhe se ky dënim do t'i shërbej preventivës gjenerale, posaçërisht asaj individuale, forcimit të moralit të shoqërisë, si dhe përgjegjësisë dhe disiplinës së qytetarëve, se me dënimin e shqiptuar kryerësi do ta parandalohet nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, do të bëhet rehabilitimi i tij dhe do të ndikojë në përmbajtjen e peronave tjerë nga kryerja e veprave penale, kjo gjykatë konsideron se me dënimin e shqiptuar nga gjykata e shkallës së parë do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitën e nenit 41 të KPRK-së.

Nga sa u tha më lartë, e në bazë të nenit 401 të KPPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## **GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**

PA1.nr.1337/18, datë 11.01.2019

Zyrtari ligjor  
Shaban Prekalla

Kryetari i kolegjit  
Hashim Çollaku

### **Anëtarët e kolegjit:**

Ferit Osmani  
Shqipe Qerimi